



ZHVILLOHET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “RITHEKSIMI I PAVARËSISË SË AUTORITETIT RREGULLATOR TË SEKTORIT FINANCIAR”

31 tetor

Vijon në faqen 2

VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-tetor 2012

Vijon në faqen 3

*Zhvillimet e tregut të Fondeve të Investimeve për
nëntëmujorin 2012*

Vijon në faqen 5

ZHVILLIME TË TJERA

AMF publikon Raportin e Mbikëqyrjes 2011

Vijon në faqen 6

*Vlerësimi i Parimeve Themelore të IAIS-it
(8-11 tetor)*

Vijon në faqen 7

*Zhvillon punimet Konferenca e 19-të vjetore e Organizatës
Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS
(7-12 tetor 2012)*

Vijon në faqen 7

*Konferencë Ndërkombëtare mbi zhvillimin e tregut të sigurimeve të Jetës:
Mundësitë dhe Sfidat
(17-18 tetor)*

Vijon në faqen 8

*Aplikimi i teknikave të menaxhimit të riskut dhe të kuptuarit e modeleve
të brendshme
(14-19 tetor)*

Vijon në faqen 8

*Qeverisja e shoqërive që veprojnë në tregun e letrave me vlerë dhe
sanksionet ndaj abuzimeve në këtë treg
(23-26 tetor)*

Vijon në faqen 9

*Projekt i ri i AMF-së - Polica e
sigurimit të automjeteve do të
përmblajë tashmë edhe kodin e
transaksionit bankar të pagesës*

Vijon në faqen 9

*Takime pune me përfaqësues të
shoqatave, instituteve kombëtare
dhe rregullatore të sigurimeve,
ANIA dhe ISVAP, Itali, në kuadër të
projektit për liberalizmin e sigurimit
të detyrueshëm motorik
(7-9 nëntor)*

Vijon në faqen 10

*Mundësitë rajonale të sigurimit të
kapitaleve nga kompanitë kosovare
(15 nëntor)*

Vijon në faqen 11

*Legjislacioni i BE-së për shërbimet
financiare, kuadri i ri rregullator dhe
mbikëqyrës në fushën e sigurimit
(19-20 nëntor)*

Vijon në faqen 11

*Zhvillohet takimi “Reforma
Tranzitore nga një Institucion i
Integruar në një strukturë të re Twin
Peaks”
(27-30 nëntor)*

Vijon në faqen 12

TË REJA NGA RAJONI

Nëntëmujori i vitit 2012

ÇEKI

Vijon në faqen 12

BOSNJE-HERCEGOVINË

Vijon në faqen 13

TURQI

Vijon në faqen 13

ZHVILLOHET KONFERENCA NDËRKOMBËTARE “RITHEKSIMI I PAVARËSISË SË AUTORITETIT RREGULLATOR TË SEKTORIT FINANCIAR” 31 tetor

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare zhvilloi më 31 tetor konferencën ndërkombëtare “Ritheksimi i pavarësisë së autoritetit rregullator të sektorit financiar” me pjesëmarrje të gjerë të autoriteteve rregullatore nga rajoni dhe ekspertëve të tregjeve financiare.

Në panelin përshëndetës morën pjesë Kryeministri i vendit Prof. Dr. Sali Berisha, Ministri i Financave, Z. Ridvan Bode, Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian, Z. Ettore Sequi, Drejtori i Misionit të USAID në Shqipëri, Z. Jim Barnhart, si edhe mjaft personalitete të tjera të vendit.



Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, në konferencën ndërkombëtare “Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar”

Duke theksuar në fjalën e saj përshëndetëse rëndësinë që ka pavarësia si një faktor kryesor për zhvillimin e tregut, Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nënvizoi ndër të tjera se “Pavarësia është një domosdoshmëri për arritjen dhe konsolidimin e zhvillimit. Një ambient transparent dhe i qëndrueshëm nxit besimin e konsumatorëve dhe njëkohësisht inkurajon konkurrencën e ndershme të të gjithë pjesëmarrësve në treg”.

Kryeministri i Shqipërisë Prof. Dr. Sali

Berisha vlerësoi punën e madhe që stafi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare ka bërë duke përballuar sfidat e shumta që ky autoritet ka kaluar me sukses në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregut. Duke e vënë theksin tek edukimi i vazhdueshëm financiar i publikut, Kryeministri mbështeti



Pjesëmarrësit në konferencën ndërkombëtare “Ritheksimi i Pavarësisë së Autoritetit Rregullator të Sektorit Financiar”

idenë se pavarësia e enteve rregullatore përbën kushtin vendimtar të funksionimit e përmbushjes së misionit të tyre. Kjo përgjegjësi, theksoi Kryeministri është edhe përgjegjësia më e madhe ndaj tregut, ligjit dhe konsumatorit.

Kryeministri Berisha gjithashtu theksoi se leksioni më i madh që del nga kriza e botës financiare është zbatimi rigoroz jashtë çdo ndërhyrjeje ligjeve mbi të cilat këto institucione veprojnë. Në përfundim Kryeministri shprehu angazhimin për mbështetjen e Qeverisë ndaj AMF-së në kapërcimin e sfidave që lidhen me pavarësinë, duke ritheksuar se pavarësia përbën kushtin vendimtar.

Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri Z. Ettore Sequi, tha se “... sidomos në këtë kohë krizash, forcimi i mbikëqyrjes financiare bëhet gjithnjë e më i nevojshëm.” Ai gjithashtu përcolli fokusin e tij tek konsumatori kur

Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nënvizoi ndër të tjera se “Pavarësia është një domosdoshmëri për arritjen dhe konsolidimin e zhvillimit. Një ambient transparent dhe i qëndrueshëm nxit besimin e konsumatorëve dhe njëkohësisht inkurajon konkurrencën e ndershme të të gjithë pjesëmarrësve në treg”.

ai tha se le të mos harrojmë se kriza ka patur ndikim të drejtpërdrejtë tek konsumatori duke e vënë atë në qendër të problematikave.

Duke vlerësuar zhvillimet e deritanishme të rregullatorëve të tregut financiar në Shqipëri, Z. Jim Barnhart, Drejtori i Misionit të USAID në Tiranë tha se janë pikërisht këto institucione që kanë siguruar një ambient të shëndetshëm, të sigurtë dhe mbështetës për biznesin. Më tej ai përforcoi idenë që rregullatorët tani “duhet të kenë pavarësi më të madhe financiare për të shmangur konfliktin e interesave”. Ai gjithashtu mbështeti idenë që projektligji dhe propozimet e tjera legislative të bëra nga AMF të aprovohej nga Parlamenti deri në fund vitit.

Duke theksuar praktikën e tyre të deritanishme, drejtuesit e mjaft autoriteteve rregullatore nga rajoni, pjesëmarrës në konferencë, realizuan një shkëmbim idesh dhe përjasje të praktikave më të mira për forcimin e rolit të autoriteteve rregullatore në tregjet financiare. Pjesëmarrës ishin përfaqësues të autoriteteve rregullatore nga Estonia, Holanda, Hungaria, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Polonia, Serbia, Sllovenia, Turqia dhe SHBA.

Interes specifik për mbikëqyrjen dhe rolin e rregullatorëve në tregjet financiare paraqitën edhe prezantimet e ekspertëve nga Banka Qendrore Europiane, Zyra e Komisionerit të Shtetit të Washingtonit, SHBA dhe ish Komisionerja e Departamentit të Bankave dhe Sigurimeve, Nju Xhersi, SHBA.



VËSHTRIM MBI TREGJET

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-tetor 2012

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-tetor 2012 arritën shifrën 7,394,089 mijë lekë, përkundrajt 7,092,667 mijë lekë të realizuara në janar-tetor 2011 ose 4.25% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 50.10% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 49.90% të tregut. Përsa i takon tregut, në veçanti,

kemi një rënie në masën 19.37% të sigurimeve të Jetës dhe një rritje prej 7.78% të sigurimeve të Jo-Jetës. Nga të ardhurat gjithsej të tregut 90.46% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.49% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.06% nga veprimtaria e risigurimit. Në janar-tetor 2012 u nënshkruan rreth 1,007,218 kontrata sigurimi, ose 7.76% më pak se në janar-tetor 2011.

Struktura e tregut të sigurimeve, për janar-tetor 2012




Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar-tetor 2012 ishin 4.25% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar.

Për janar-tetor 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,704,596 mijë lekë, ose 3.54% më pak se të ardhurat e janar-tetor 2011.

Volumi i primit të shkruar bruto, për periudhën janar-tetor 2011, 2012

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë Lekë)	
janar-tetor	2011	2012
A) Sigurim i Jetës	869,821	701,369
B) Sigurim i Jo-Jetës	6,205,729	6,688,411
<i>Nga këto:</i>		
a) Sigurimi Detyrueshëm	3,252,285	3,689,493
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	2,953,444	2,998,918
C) Risigurimi	17,117	4,309
TOTAL	7,092,667	7,394,089

Volumi i primit të shkruar bruto, për janar-tetor 2012 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet e detyrueshme motorike

Në janar-tetor 2012, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 3,689,493 mijë lekë të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme për janar-tetor 2012, arritën 2,683,545 mijë lekë, ose 41.30% më shumë se janar-tetor 2011.

Në janar-tetor 2012, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 551,023 mijë lekë, ose rreth 44.61% më pak se në janar-tetor 2011. Kjo ulje e primit shkruar bruto Karton Jeshil lidhet me liberalizimin tregut të sigurimit të detyrueshëm në gusht të vitit 2011.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë janar-tetor 2012 arritën në 454,925 mijë lekë, apo 27.00% më shumë se në janar-tetor 2011.

Sigurimet vullnetare

Për janar-tetor 2012, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 3,704,596 mijë lekë, ose 3.54% më pak se të ardhurat e janar-tetor 2011.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 2,998,918 mijë lekë, vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe dëme të tjera në pronë me 45.95%, të pasuara nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit me 17.64%, dhe nga sigurimi kasko me 15.22%, peshë më të ulët patën sigurimi i përgjegjësi të përgjithshme civile, sigurimet e garancisë.


Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar-tetor 2012 arritën në 529,129 mijë lekë, 30.62% më pak se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e klasës 1, sigurimi i aksidenteve me 60.72% të të ardhurave të këtij grupi.

Primet në sigurimet e jetës në janar-tetor 2012 arritën në 701,369 mijë lekë, ose 19.37% më pak se në janar-tetor 2011.


Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: SIGAL UNIQA Group Austria, SIGMA Vienna Insurance Group, INSIG, ATLANTIK, INTERALBANIAN, ALBSIG, INTERSIG Vienna Insurance Group EUROSIG dhe ANSIG. SIGAL UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 31.59% të primeve.

Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-tetor 2012 (Jo-Jeta)



Pjesëmarrja e shoqërive në tregun e sigurimit, për janar-tetor 2012 (Jeta)



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria, INSIG dhe SICRED. SIGAL-LIFE UNIQA Group Austria udhëhoqi tregun me 51.77% të primeve.

Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-tetor 2012 kapi vlerën 2,282,924 mijë lekë, ose 31.98% më shumë se në janar-tetor 2011. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 1,686,544 mijë lekë, apo 73.88% të totalit.

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar-tetor 2012 kapi vlerën 2,282,924 mijë lekë, ose 31.98% më shumë se në janar-tetor 2011.

Zhvillimet e tregut të Fondeve të Investimeve për nëntëmujorin 2012

Viti 2012 shënoi fillimin e aktivitetit në tregun e fondeve të investimeve. Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj, i administruar nga Shoqëria “Raiffeisen Invest - shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a., filloi veprimtarinë e tij më 1 shkurt 2012.

Aktiviteti i fondeve të investimeve kryhet në përputhje me Ligjin nr. 10198, datë 10.12.2009 “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”. Në mbështetje të këtij ligji, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare licenoi në datë 13.12.2011, shoqërinë “Raiffeisen Invest - shoqëri

Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive” sh.a.

Shoqëria “Raiffeisen Invest” sh.a., aktualisht administron dy fonde investimesh “Fondin e Investimeve Raiffeisen Prestigj”, i licencuar më datë 13.12.2011 dhe “Fondin Raiffeisen Invest Euro”, i licencuar më datë 26.09.2012.

Qëllimi i fondeve të investimit të licencuara deri tani nga AMF është ofrimi i një kthimi nga investimi nën një menaxhim të kujdesshëm

të portofolit, duke ruajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetin e nevojshëm.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e Fondeve të Investimeve, në 30.09.2012, vlera e aseteve neto të Fondit Raiffeisen Prestigj arriti në vlerën 16.9 mld. lekë,

e cila dominohet nga investimet në Obligacione të Qeverisë, të cilat zënë 84.96% të totalit të aseteve të fondeve. Numri i anëtarëve në fondet e investimit është 7,149. Vlera e aseteve neto nën zotërim të investitorëve individualë është 57,98% të totalit.

Përshkrimi	Nr.	Vlerë (lekë)	%
30.09.2012			
Numri i shoqërive administruese të fondeve të investimeve	1		
Numri i Fondeve të Investimit	2		
Numri i Anëtarëve në fond	7,149	16,907,513,112	100.00
<i>Individë</i>	7,146	9,803,060,918	57.98
<i>Persona juridikë</i>	3	7,104,452,194	42.02
Vlera më e ulët e vlerës neto të aseteve për kuotë		1,000.00	
Vlera neto e aseteve për kuotë		1,039.64	
Kthimi total*			3.96

*ky tregues është përllogaritur për një horizont investimi nga 31.03.2012 deri në 30.09.2012.

Përshkrimi	31.03.2012	30.09.2012	Ndryshimi në %	Pjesa ndaj totalit në %	
				31.03.2012	30.09.2012
Asetet neto të fondit	1,408,154,993	16,907,512,643	1,100.69		
Totali i aseteve të fondit	1,416,546,705	16,944,850,879	1,096.21	100.00	100.00
<i>nga të cilat</i>					
Obligacione Qeveritare (brenda vendit)	537,854,349	14,395,735,425	2,576.51	37.97	84.96
Bono Thesari (brenda vendit)	669,330,778	1,55,321,165	132.52	47.25	9.18
Mjete Monetare	205,961,224	661,176,237	221.02	14.54	3.90
Asete të tjera	3,400,355	331,618,053	9,652.45	0.24	1.96
<i>Totali i detyrimeve të fondit</i>	<i>8,391,712</i>	<i>37,338,235</i>	<i>344.94</i>	<i>0.59</i>	<i>0.22</i>

Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj, i administruar nga Shoqëria "Raiffeisen Invest - shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive" sh.a., filloi veprimtarinë e tij më 1 shkurt 2012.

ZHVILLIME TË TJERA

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon Raportin e Mbikëqyrjes 2011

Viti 2011 shënoi forcimin e metodologjisë së mbikëqyrjes së tregut të sigurimeve. Autoriteti filloi në vitin 2008 projektin "Drejt një mbikëqyrje efektive" financiar nga First Initiative me asistencën e Bankës Botërore.

Me përfundimin e këtij projekti, u prezantuan Manuali i Mbikëqyrjes dhe Projektligji i Sigurimeve, të cilat së bashku me sistemin e raportimit AMF In-Reg përbëjnë shtyllat kryesore të metodologjisë së re.

Në thelb të këtij publikimi është informacioni statistikor-financiar i detajuar dhe tepër i strukturuar. Kështu, përveç testeve IRIS për tregun, të dhënave makro dhe informacionit tekniko-financiar për tregun e Jetës dhe të Jo-Jetës, një vend të rëndësishëm zënë dhe treguesit tekniko-financiarë të disa prej portofoleve me peshë më

të rëndësishme, me qëllim analizimin e tendencave në vite.

Raporti i Mbikëqyrjes i adresohet një numri të konsiderueshëm përdoruesish, duke filluar që nga vetë operatorët e tregut, investitorët e huaj, analistët e ndryshëm dhe deri për qëllime akademike.

Vlerësimi i Parimeve Themelore të IAIS-it

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë (PFSA) në bashkëpunim me Qendrën për Trajnime Ndërkombëtare të Torontos zhvilluan gjatë periudhës 8-11 tetor 2012 në Varshavë, Poloni seminarin rajonal mbi Vlerësimin e Parimeve Themelore të IAIS-it.

Gjatë seminarit pjesëmarrësit u njohën me strukturën e rishikuar të disa parimeve themelore të rishikuara të sigurimeve të IAIS-it (ICP), hartën e kalimit nga parimet e vjetra në të reja, hierarkinë e parimeve, standardeve dhe udhëzuesin, cilat janë parimet e reja të IAIS-it, synimi i metodologjisë së vlerësimit, parakushtet për një mbikëqyrje efektive, si dhe struktura institucionale dhe tregu.

Nëpërmjet eksperiencave konkrete seminari në veçanti u fokusua në: *Parimin (ICP) 4 mbi licencimin; Parimin (ICP) 5 mbi përshtatshmërinë e personave; Parimin (ICP) 6 mbi ndryshimet në kontrollin dhe transfertat e portfolit; Parimin (ICP) 7 mbi qeverisjen e korporatave; Parimin (ICP) 8 mbi menaxhimin e riskut dhe kontrollet e brendshme; Parimin (ICP) 9 mbi rishikimin e mbikëqyrjes dhe raportimin; Parimin (ICP) 15 mbi investimet dhe në Parimin (ICP) 16 mbi menaxhimin e riskut dhe ndërmarrjet.*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua në këtë takim nga Znj. Enkela Idrizi, Nënkyetare e Autoritetit.

Zhvillon punimet Konferenca e 19-të vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) zhvilloi gjatë periudhës 7-12 tetor 2012, në Washington D.C. SHBA, Konferencën e 19-të Vjetore të IAIS-it me temë “Mbikëqyrja në Sigurime: Themelore për Fuqizimin Financiar Botëror”. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin mbi 600 përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve, shoqëritë e sigurimeve, ekspertë dhe zyrtarë të lartë të organizatave ndërkombëtare si Fondi Monetar

Ndërkombëtar dhe Banka Botërore.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si anëtar me të drejta të plota i kësaj organizate, u përfaqësua në këtë aktivitet nga Nënkyetari, Z. Mati Pepa, anëtarja e Bordit të Autoritetit Znj. Kestrin Katro dhe Znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit Juridik.

Në panelet kryesore të Konferencës, diskutimet u përqendruan kryesisht në

Një ndër çështjet që tërhoqi më shumë diskutime ishte mbikëqyrja e korporatave.

mbikëqyrjen me bazë të gjerë në tregun e sigurimeve duke përfshirë edhe standardet e sigurimit dhe menaxhimin e riskut. Një ndër çështjet që tërhoqi më shumë diskutime ishte mbikëqyrja e korporatave. Gjithashtu u diskutua për marrëdhëniet midis autoriteteve mbikëqyrëse në funksion të përmbushjes së objektivit kryesor, mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe garantimit të stabilitetit financiar në

rajon dhe më gjerë. Gjithë diskutimet u panë në këndvështrimin e zhvillimeve të shpejta pas krizës së tregut financiar dhe reagimeve politike nga e gjithë bota. Konferenca i dhambështetje Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) në misionin e saj, për vendosjen e standardeve globale, të efektshme, të sigurimit, në lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse.

Konferencë Ndërkombëtare mbi zhvillimin e tregut të sigurimeve të Jetës: Mundësitë dhe Sfidat

Agjencia e Mbikëqyrjes së Malit të Zi në bashkëpunim me Dhomën e Ekonomisë së Malit të Zi organizuan në Budva në datat 17-18 tetor 2012 konferencën e parë ndërkombëtare me temë: “Zhvillimi e Tregut të Sigurimeve të Jetës: Mundësitë dhe Sfidat”.

Diskutimet kryesore ishin nga Z. Peter Braumuller, Kryetar i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), Z. Peter Baier, Përfaqësues i Autoritetit Mbikëqyrës të Gjermanisë (BAFIN), Z. Klime Poposki, President i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë.

Gjatë zhvillimit të konferencës u diskutua mbi parimet themelore të sigurimeve (ICP) me fokus të veçantë në ICP 18 dhe ICP 19 dhe mbrojtjen e policëmbajtësve. Ndër aspektet kyçe

që kanë ndikim të drejtpërdrejtë mbi mbrojtjen konsumatore u përmendën: kapitali i mjaftueshëm, trajtimi i drejtë i konsumatorëve, mbikëqyrja efektive nga ana e rregullatorëve, si dhe përcaktimi i standardeve dhe rregulloreve përkatëse. Gjithashtu u diskutua për standardet minimale për dhënien e informacionit nga policat e sigurimit të Jetës. Vëmendje e veçantë në diskutime ju kushtua rolit dhe ndikimit që kanë bankat si një faktor i rëndësishëm zhvillimi për tregun e sigurimeve të Jetës.

Përfaqësuesi i Autoritetit Rregullator të Austrisë propozoi një produkt të ri të sigurimit të Jetës zhvilluar për herë të parë në Austri, produkt i cili ofron një paketë ndihme mjekësore për të siguruarit, të cilët arrijnë moshën madhore. U propozua që ky produkt mund të ofrohet edhe në zonën e Ballkanit.

Aplikimi i teknikave të menaxhimit të Riskut dhe të kuptuarit e modeleve të brendshme

Instituti i Stabilitetit Financiar (FSI) zhvilloi në Beatenberg, në datat 14-19 tetor seminarin me temë “Mbi aplikimin e teknikave të menaxhimit të Riskut, si dhe mbi të kuptuarit e

modeleve të brendshme”.

Temat kryesore që u trajtuan gjatë seminarit ishin: Përdorimi i modeleve të brendshme financiare; menaxhimi

Gjatë zhvillimit të konferencës u diskutua mbi parimet themelore të sigurimeve (ICP) me fokus të veçantë në ICP 18 dhe ICP 19 dhe mbrojtjen e policëmbajtësve.

i riskut për shoqëritë e risigurimeve; Përshkrimi i një shembulli mbi modelin e shitjes se një kontrate Pasurie dhe Aksidenti; Përdorimi praktik mbi modelet e brendshme të menaxhimit të riskut për kontratat e Pasurisë dhe Aksidentëve, sipas programit të sofistikuar Igloo; Modelet matematikore të analizimit të riskut

si korrelacioni linear dhe Kopula; Validime praktike të modeleve të brendshme; Menaxhimi i pasigurive në një treg kompleks, të pasigurtë.

Gjatë seminarit u diskutua lidhur me kushtet teknike të nevojshme për zbatimin e mbikëqyrjes me bazë risku për sigurimin e katastrofave.

Qeverisja e shoqërive që veprojnë në tregun e letrave me vlerë dhe sanksionet ndaj abuzimeve në këtë treg

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) zhvilloi gjatë periudhës 23-26 tetor 2012 në Madrid, Spanjë seminarin me temë “Çështje që lidhen me qeverisjen e shoqërive të cilat merren me tregtimin e titujve dhe sanksionet për abuzimin e tregut të letrave me vlerë”.

Gjatë seminarit u trajtuan çështjet e lidhura me sfidat e rregullatorëve të tregut të letrave me vlerë në drejtim të qeverisjes së shoqërive dhe llojet e sanksioneve që duhen ndërmarrë në rastet e abuzimit me tregun e letrave me vlerë. Të gjitha këto u diskutuan edhe nën këndvështrimin e mësimëve të nxjerra nga kriza e fundit financiare.

Zv/Sekretari i përgjithshëm i IOSCO-s, z. Tajinder Singh, prezantoi zhvillimet

më të fundit të IOSCO-s, përpjekjet për të rritur peshën e saj në raport me organizma të tjerë si FSB e G20 dhe idenë e krijimit të Fondacionit të IOSCO-s, i cili ka për qëllim të sigurojë fonde për të financuar aktivitete në tregun e letrave me vlerë.

Ndër temat e kryesore të trajtuara në seminar ishin edhe qeverisja e korporatave dhe institucionet financiare, parimet e OECD-së si një pikë referimi për një qeverisje të mirë si edhe u dhanë shembuj nga qeverisja e korporatave dhe institucionet financiare në Angli, Gjibraltari, si dhe sfidat e ardhshme. Diskutime pati edhe rreth përgjegjësitë e auditëve, rritja e pavarësisë së auditorëve, forcimin e rolit të komitetit të auditimit pranë bordeve të shoqërive, përmirësimi i transparencës në auditim, etj.

Gjatë seminarit u trajtuan çështjet e lidhura me sfidat e rregullatorëve të tregut të letrave me vlerë në drejtim të qeverisjes së shoqërive dhe llojet e sanksioneve që duhen ndërmarrë në rastet e abuzimit me tregun e letrave me vlerë.

Projekt i ri i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare - Polica e sigurimit të automjeteve do të përmbajë tashmë edhe kodin e transaksionit bankar të pagesës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare që prej datës 1 nëntor ka filluar zbatimin e projektit “Integrimi i Regjistrimit të Policave me shitjen nëpërmjet Sistemit Bankar”. Ky projekt nëpërmjet përfshirjes së detyrueshme të transaksionit të pagesës në policat e sigurimit, mundëson zhvillimin

dhe kontrollin e tregut të sigurimeve motorike dhe jep mundësinë e krijimit të standardeve në veprimet financiare duke filluar nga lëshimi i policave të sigurimit të detyrueshëm motorik e deri në pagesën e dëmeve si rrjedhojë e tyre.

Me fillimin e zbatimit të këtij projekti, konsumatorët do të shohin disa informacione shtesë në policën e tyre të sigurimit të detyrueshëm motorik. Përveç Kodit të Raportimit AMF, do të jetë i pranishëm dhe kodi i transaksionit bankar, të cilit i referohet polica e sigurimit. Për konsumatorët këto kode janë garancia e lëshimit të rregullt të policës së sigurimit të detyrueshëm

motorik dhe i transmetimit të të dhënave të tyre në AMF.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në këtë mënyrë rrit cilësinë e monitorimit të shoqërive të sigurimeve në drejtim të raportimit të saktë të policave të shitura, duke realizuar kështu funksionet e tij të rëndësishme, mbrojtjen e konsumatorit dhe forcimin të tregut të sigurimeve.

Takime pune me përfaqësues të shoqatave, instituteve kombëtare dhe rregullatore të sigurimeve, ANIA dhe ISVAP, Itali, në kuadër të projektit për liberalizmin e sigurimit të detyrueshëm motorik

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, së bashku me një grup pune morën pjesë gjatë periudhës 7-9 nëntor në takimet me përfaqësues të Shoqatës Kombëtare të Shoqërive të Sigurimeve të Italisë, ANIA dhe Institutin për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Private dhe Interesave Kolektive, ISVAP, si institucion rregullator, në kuadër të projektit për liberalizmin e sigurimit të detyrueshëm motorik. Programi u realizua me mbështetjen e Bankës Botërore dhe Programit “First Initiative”.

ANIA është një organizëm i krijuar që në vitin 1944 dhe përmbledh rreth vetës mbi 173 shoqëri sigurimi, të cilat kanë rreth 90% të volumit të primeve në tregun italian të sigurimeve. Gjatë takimeve me përfaqësues të lartë të saj u shkëmbyen eksperiencat në lidhje me ndërtimin e bazës së të dhënave për kontratat e sigurimit të detyrueshëm motorik pranë autoriteteve rregullatore, mbi variablet kryesore që duhen marrë në konsideratë në ndërtimin e kësaj baze të dhënash, mbi kategorizimin në klasa të personave të siguruar sipas sistemit Bonus-Malus, variablet kryesore që do të merren në konsideratë për llogaritjen e primit të riskut, identifikimi dhe menaxhimi i

rasteve mashtruese, si dhe mbi kërkesat rregullatore me të cilat ISVAP operon në tregun e sigurimeve në Itali.

Ndërtimi i kësaj baze të dhënash është shumë i rëndësishëm për veprimtarinë mbikëqyrëse të autoriteteve rregullatore, pasi aty pasqyrohet informacioni për dëmet, për efekt të vlerësimit të risqeve aktuariale, si dhe të dhënat e dëmeve për efekt të identifikimit të rasteve mashtruese. Gjithashtu në këto takime u diskutua mbi monitorimin e sistemit të tarifave të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik, si dhe rolin e aktuarëve në llogaritjen e rezervës së dëmeve e tarifave të kontratave të sigurimit të detyrueshëm motorik.

Një takim të veçantë pune, Kryetarja e Autoritetit, Znj. Enkeleda Shehi zhvilloi me Znj. Flavia Mazzarella, Zëvendës Menaxhere e Përgjithshme e Institutit për Mbikëqyrjen e Sigurimeve Private dhe Interesave Kolektive, ISVAP. Ky është një institucion rregullator i pavarur, i krijuar që në 1982, që vepron për të siguruar stabilitetin dhe mirëfinancimin e sistemit të sigurimeve, si dhe mbrojtjen e konsumatorëve. Gjatë takimit u shkëmbyen mendime për mundësitë e zgjerimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në mjaft drejtime dhe sidomos në

Përveç Kodit të Raportimit AMF, do të jetë i pranishëm dhe kodi i transaksionit bankar, të cilit i referohet polica e sigurimit.

mbrojtjen e konsumatorëve, ku ky institucion ka një përvojë të veçantë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, u përfaqësua në këto takime nga Znj.

Enkeleda Shehi, Kryetare, Z. Rinald Guri, Drejtor i Departamentit TI, Kërkimit dhe Statistikës, Z. Donald Papalilo, Drejtor i Drejtorisë TI-së dhe Znj. Juliana Dengeri, Aktuar.

Mundësitë rajonale të sigurimit të kapitaleve nga kompanitë kosovare

Ministria e Financave në Kosovë në bashkëpunim me Shoqatën e Bankave të Kosovës, USAID, PFS program (Programi për Stabilitet Financiar), Zyrën e Asistencës Teknike dhe Departamentin e Thesarit, SHBA, zhvilluan në 15 nëntor 2012, në Prishtinë, konferencën e tregjeve të kapitalit me temë: “Mbi mundësitë rajonale të sigurimit të kapitaleve nga kompanitë kosovare.” Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua në këtë konferencë nga znj. Enkela Idrizi, Nënkryetare e Autoritetit.

Ekspertë të rajonit prezantuan dhe diskutuan, mbi mundësitë dhe kriteret që duhet të përmbushin kompanitë kosovare në drejtim të sigurimit të kapita-

leve në tregun rajonal të kapitaleve, mbi integrimin rajonal të tregjeve të kapitaleve në Evropën Juglindore, rolin e ndërmjetësve financiar, kuadrin ligjor dhe rregullator të nevojshëm, si dhe mbi ligjet dhe rregullat e nevojshme në realitetin ekonomik kosovar.

Nënkryetarja e AMF-së, Znj. Enkela Idrizi ishte pjesë e diskutimit në panelin “Tregjet e kapitaleve, çështje të lidhura me sistemin rregullator ligjor, cilat ligje dhe rregullore janë të nevojshme në Kosovë”. Në këtë panel u trajtua eksperiencia e autoritetit rregullator në Shqipëri lidhur me rregullimin dhe aktivizimin e tregut të kapitaleve, si dhe sfidat që paraqet ky proces, në realitetin ekonomik të Kosovës.

Legjislacioni i BE-së për shërbimet financiare, kuadri i ri rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e sigurimit

Instituti Evropian i Administrimit Publik (IEPA) zhvilloi gjatë 19-20 nëntor në Luksemburg, seminarin me temë “Legjislacioni i BE-së në fushën e shërbimeve financiare, kuadri i ri rregullator dhe mbikëqyrës në fushën e sigurimit”.

Pjesë e programit ishte prezantimi i objektivave dhe politikave të Komisionit Evropian në fushën e sigurimit, si dhe problemet praktike në lidhje me zbatimin e akteve ligjore të BE-së, për fushën e sigurimeve, në nivel kombëtar, ku një rëndësi e veçantë ju kushtua problemeve lidhur me zbatimin e Solvency II. Gjithashtu në seminar

u diskutua lidhur me procedurën legjislative para dhe pas Traktatit të Lisbonës, në lidhje me praktikën e re të delegimit të kompetencave zbatuese të Komisionit Evropian. Në seminar u prezantua edhe procedura e quajtur “Lamfalussy” lidhur me miratimin dhe zbatimin akteve ligjore të BE-së në fushën e shërbimeve financiare.

Seminari shërbeu për dhënie të njohurive të reja të kuadrin rregullativ dhe mbikëqyrës në fushën e sigurimit dhe si platformë për shkëmbimin e përvojës dhe informacionit midis rregullatorëve, qeverisë, industrisë,

Ekspertë të rajonit prezantuan dhe diskutuan, mbi mundësitë dhe kriteret që duhet të përmbushin kompanitë kosovare në drejtim të sigurimit të kapitaleve në tregun rajonal të kapitaleve, mbi integrimin rajonal të tregjeve të kapitaleve në Evropën Juglindore, rolin e ndërmjetësve financiarë, kuadrin ligjor dhe rregullator të nevojshëm, si dhe mbi ligjet dhe rregullat e nevojshme në realitetin ekonomik kosovar.

organizatave tregtare dhe grupeve me të cilat po përballen institucionet të interesit lidhur me sfidat praktike financiare dhe vetë tregu i sigurimeve.

Zhvillohet takimi “Reforma Tranzitore nga një Institucion i Integruar në një Strukturë të re Twin Peaks”

Në datat 27–30 nëntor u zhvillua në Londër takimi ndërkombëtar “*Reforma Tranzitore nga një Institucion i Integruar në një Strukturë të re Twin Peaks*”. Aktiviteti u zhvillua, nën organizimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Britanisë së Madhe, FSA. Në këtë seminar marrin pjesë përfaqësues nga autoritete të ndryshme rregullatore të sektorit të sigurimeve, sektorit bankar dhe të letrave me vlerë nga mbarë bota.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, u përfaqësua në këtë takim nga Kryetarja, Znj. Enkeleda Shehi.

Tematika kryesore e diskutimit ishte lidhur me paraqitjen e eksperiencave në procesin e kalimit nga institucion i integruar në strukturën e re “Twin

Peaks”. Ky modeli ri reflektohet edhe në mënyrën e organizimit dhe veprimet të dy autoriteteve të reja në të ardhmen, mënyrën se si do të punohet me subjektet e mbikëqyrura, në përgatitjen e bazës juridike për të dy autoritetet, etj.

Çështjet kryesore u prezantuan nga disa referime të mbajtura nga ekspertë të nivelit të lartë të FSA dhe të autoriteteve financiare rregullatore nga SHBA, India, Holanda, etj. Gjithashtu pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare financiare si Zëvendës Sekretarja e Përgjithshme e Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime, IAIS, Znj. Catherine Lezon, përfaqësues nga FMN, etj.

TË REJA NGA RAJONI

Të dhëna për nëntëmujorin e vitit 2012

Informacion i marrë nga XPRIMM News <http://www.xprimm.com>

Çeki: Rritje e ngadaltë e shtyrë nga sigurimi i Jetës

Tregu i sigurimeve në nëntëmujorin e parë të 2012 shënoi një rritje të ngadaltë. Primet e shkruara bruto të 31 siguruesve të ribashkuar nga Shoqata e Sigurimeve Çeke u rrit me rreth 0.2%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me një rritje në vlerë absolute prej 153 milion CZK (Koruna). Në valutën Evropiane, për shkak të zhvlerësimit të monedhës vendase në lidhje me EUR, industria e sigurimeve lokale raportoi një ulje prej 0.3 % me pothuajse 3.48 milion EUR.

Primet e shkruara bruto të sigurimit të

Jo-Jetës arritën vlerën 52.05 milion CZK ose 1.2% më pak krahasuar me periudhën janar-shtator 2011, ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën vlerën prej 34.43 milion CZK, me një rritje prej 2.3%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Një nga arsytet e rënies së sigurimit të Jo-Jetës është volumni i ulët të primeve të shkruara bruto në dy klasat e sigurimeve motorike: rasti i DMTPL me një ulje prej 5.5% dhe sigurimi Kasko me një ulje prej 2%.

Tregu i sigurimeve në nëntëmujorin e parë të 2012 shënoi një rritje të ngadaltë.

Bosnje Hercegovinë: Rritje e qëndrueshme e tregut të sigurimeve

Tregu i sigurimeve në Bosnje dhe Hercegovinë, pati një rritje me 2.87% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Të 25 siguruesit rezidentë të Bosnje Hercegovinës arritën vlerën prej 195.17 milion EUR

gjatë nëntëmujorit të vitit 2012, nga të cilën 83.84% i përkasin sigurimit të Jo-Jetës. Sigurimi i Jo-Jetës pati një rritje prej 2% ose 163.63 milion EUR, ndërkohë që sigurimi i Jetës është rritur me 7.59% ose 31.53 mil. EUR.

Turqi: Industria e sigurimeve në rritje të vazhdueshme

Tregu i sigurimeve në Turqi e mbylli nëntëmujorin e parë të vitit 2012 me një total të primit të shkruar bruto rreth 14.31 miliard TRY (Turkish lira) ose 6.2 miliard EUR, me një rritje në monedhën lokale prej 13.29% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011.

Volumi i primit të Jo-Jetës arriti TRY 12.29 bilion TRY (5.3 bilion EUR), me një ndryshim pozitiv prej 16.83% gjatë të njëjtës periudhë të vitit 2011. Nga ana tjetër, degët e Jetës raportuan një rënie vjetore 4.38%, duke mbledhur një prim prej 2 bilion TRY (pothuajse 874 milion EUR).

Për shkak të një normë rritje të konsiderueshme që tejkalon shumë mesataren e tregut (pothuajse 23% në terma vjetorë) linjat e sigurimit motorik kanë rritur peshën e tyre në portofolin e tregut me rreth 42%. Kështu, primi i përgjithshëm i shkruar bruto për sigurimin motorik arriti 6 bilion TRY, nga të cilat sigurimi Kasko shënoi 3.25 bilion TRY (deri 18.8% në terma vjetorë). Megjithatë, dinamika më e mirë u arrit për linjën TPL për të cilën primi i shkruar bruto arriti 2.77 bilion TRY, e ndjekur nga një rritje në terma vjetorë 27.8%.

Tregu i sigurimeve në Turqi e mbylli nëntëmujorin e parë të vitit 2012 me një total të primit të shkruar bruto rreth 6.2 miliard EUR, me një rritje afro 13,29% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011.

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, T. Cani, M. Vaska, J. Mele, J. Dengeri, L. Lloji, G. Hysi, P. Berberi, R. Eltari, E. Beqir-Aga, E. Kokona, Dh. Hazbiu

